

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOŠOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-2546
Data / Datum / Date: 03 / 12 / 20 08
Shtojca / Dodaci / Annex: _____
PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.03 /2008

PAGESA PËR PUNË GJATË KUJDESTARISË, KUJDESTARISË NË (GADISHMERI) ME DALJE NË TERREN DHE GJATË NATËS

MBI KOMPENSIMET STIMULUESE PËR PUNË TË VEÇANTË DHE SPECIFIKE OË KRYEN STAFI PROFESIONAL I ZYRËS PËR PERSONA TË ZHDUKUR DHE MJEKËSI LIGJORE (ZPZHML) NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Ministria e Drejtësisë,

Në mbështetje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, të datës 13 shtator, 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenet 1.3, 1.6 dhe 1.7. e në pajtim me nenin 2.2 nën (n) Shtojca XV të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/53 mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/26 mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, dhe sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të datës 13.06.2006 mbi bartjen kompetencave nga Departamenti i Drejtësisë UNMIK, në MD të ZPZHML, Ministria e Drejtësisë nxjerr udhëzim administrativ.

**KOMPENSIMET STIMULUESE
PËR PUNË TË VEÇANTË DHE SPECIFIKE**

Neni 1.

1.1. Me këtë udhëzim administrativ Ministria e Drejtësisë rregullon në mënyrë unike kompensime stimuluuese për punën e veçantë dhe specifike me interes të përgjithshëm publik, duke kryer abdukcione mjeko-ligjore specifike profesionale, ekzaminime të veçanta me hetime të rasteve të vdekjes, të eskumimeve të kufomave, konstatimin e dhunimeve, me kryerje të punëve tjera që ndër lidhen me luftimin e krimeve ndaj jetës dhe trupit të njeriut.

1.2. Punët e përshkruara në pikën e mësipërme 1.1. të këtij neni, përveç angazhimit të rregullt të punës prej tetë (8) orësh, kërkon angazhim 24 orësh në kujdestari në vendin e punës, në kujdestarinë duke qëndruar në gatishmëri nga ora 16:00 - 08:00, dalja në terren sipas kërkesës së Organit të Hetuesisë Prokurorit Publik, Policisë së Kosovës dhe asaj ndërkombëtare, në tërë territorin e Kosovës ku paraqitet nevoja.

1.3. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim dhe marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë do të sigurojnë mjete financiare të vazhdueshme lidhur me ndarjen e mjeteve buxhetore për kompensime stimuluese të stafit profesional të ZPZHML, dhe punësim me staf të nevojshëm.

1.4. Ky udhëzim administrativ për ZPZHML është bazuar në Udhëzimin e Ministria e Shëndetësisë 06/2003 të 02 Majit 2003, ku është rregulluar kompensimi stimulues për punëtorët e Ministria e Shëndetësisë.

Kompensimi stimulues për punë të veçanta dhe specifike Neni 2.

2.1. Kompensimi stimulues sipas këtij udhëzimi administrativ: përfshinë

- i. Puna gjatë kujdestarisë është e definuar si obligim i natyrës së punës për kategorinë e caktuar të stafit profesional të ZPZHML gjatë 24 orëve;
Ora e punës gjatë kujdestarisë në punë për ditët e rregullta të punës do të paguhet për intervalin kohor prej orës 16:00 – 24:00 dhe prej orës 24:00 - 08:00;
{ Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e shtunë, të dielën dhe ditëve të festës do të paguhet për 24 orë të punës;
{ Ora e punës gjatë kujdestarisë (në gatishmëri) me dalje në terren sipas kërkesës së organit të Hetuesisë Prokurorit Publik, Policisë së Kosovës dhe asaj ndërkombëtare, në tërë territorin e Kosovës ku paraqitet nevoja, do të paguhet për orët e punës prej orës 16:00 – 08:00
- ii. Varësisht nga kategoria e stafit profesional ora e punës gjatë kujdestarisë dhe ora e punës gjatë natës gjatë ditëve të rregullta të punës do të paguhet 40% më tepër se ora e rregullt e punës;
Varësisht nga kategoria e stafit profesional ora e punës gjatë kujdestarisë (në gadishmëri) me dalje në terren sipas kërkesës së organit të Hetuesisë Prokurorit Publik, Policisë së Kosovës dhe asaj ndërkombëtare, në tërë territorin e Kosovës ku paraqitet nevoja, dhe puna gjatë ditëve të shtunë, të diele dhe gjatë festave zyrtare do të paguhet 60% më tepër se sa ora e rregullt e punës.
- iii. Parakusht për pagesën e lartpërmendur është plotësimi i kuotës së plotë të orëve të punës të paraparë për një muaj.

2.2. Orari i rregullt i punës konsiderohet puna e kryer në kohëzgjatje prej 8 orëve pune, nga ora 8:00 deri në ora 16:00, gjithashtu orar i rregullt i punës konsiderohet puna e kryer prej orës 16:00 deri në ora 24:00 dhe prej orës 24:00 deri në ora 08:00, për kategorinë e stafit profesional i cili staf përcaktohet të punojë me këtë orar për shkak të natyrës së punës, ky orar i rregullt i punës përkufizohet si Punë me ndërrime.

Plani vjetor dhe buxheti
Neni 3.

3.1. Drejtori i ZPZHML obligohet që të dorëzoj për aprovim në Ministrinë e Drejtësisë, para fillimit të vitit fiskal planin vjetor me buxhet të balansuar, duke shikuar të gjitha nevojat për mjete dhe mënyrën se si këto mjete do të përdoren për pagesën e kompensimet e autorizuara me këtë udhëzim administrativ.

3.2. Drejtori i ZPZHML obligohet të mbajë dhe parashtojë evidenca të sakta me dokumentacion përkatës dëshmuës, me paraqitjen e kërkesës për pagesat e punës së kryer nga stafi në përputhje me këtë udhëzim administrativ.

3.3. Ministria e Drejtësisë do të bëjë kompensimin sipas këtij Udhëzimi Administrativ në varësi të ekzistimit të mjeteve buxhetore të destinuara për paga dhe meditje të ZPZHML.

3.4. Kur mjetet për paga e meditje në pajtim me pikën 3.3. nuk mbulojnë shpenzimet për kompensim sipas këtij Udhëzimi Administrativ, mjetet për kompensim do të sigurohen me (bujtje) nga kontoja ekonomike shërbime dhe mallra.

Procedura e Kontrollit
Neni 4.

4.1. Kontrolli i brendshëm i aktiviteteve të lidhura me punën e kryer sipas nenit 2, të këtij udhëzimi administrativ, në pajtim me orarin dhe planin e punës që është obligim i Drejtorit të ZPZHML, e që i njëjti do të jetë edhe subjekt i kontroleve periodike nga zyra e auditorit e Ministrisë së Drejtësisë.

4.2. Ministrinë e Drejtësisë, mund të themelojë procedura të rregullta ose ad hoc të kontrollit me qëllim të sigurimit të implementimit adekuat të këtij udhëzimi administrativ.

Përgjegjësia për implementim
Neni 5.

Përgjegjësia për implementim të këtij Udhëzimi Administrativ bie në Sekretari i Përhershëm të Ministrisë së Drejtësisë, i cili nxjerrë vendim për zbatimin e tij.

Hyrja në fuqi
Neni 6.

Ky udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më: 03-12, 2008

Ministria e Drejtësisë
Znj. Nekibe Kelmendi, Ministre

Nekibe Kelmendi

